

Në vitin 1961, me dekret nr. 3238, datë 20.03 Shahin Toçi dekorohet me "URDHËRIN E TRIMËRISË", nga Presidiumi i Kuvendit Popullor

1715

REPUBLIKA POPULLORE E SHQIPËRISË
Presidiumi i Kuvendit Popullor
=====

D E K R E T
për dhënie dekorate
=====

Në mbështetje të nenit 58, pika 8, të Kushtetutës së Republikës Popullore të Shqipërisë;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
D E K O R O N :
ME URDHËRIN E TRIMËRISË

Shahin Toçi, me këtë motivacion :
" Kur fashizmi italian pas okupimit të vendit më 1939, detyronte me anën e forcës dhe të presionit ushtarakët shqiptarë që studionin në Itali, për t'u betuar për Viktor Emanuelin, si oficer e patriot shqiptar dhe si antifashist i flakët, i frymëzuar nga ndjenja të larta të atdashedashurisë, ka mbajtur ditën e betimit qëndrim të lartë patriotik deri sa dha jetën e tij për të mos iu përkulur fashizmit".

Tiranë, me 20/3/1961
Nr. i dekretit: 3238

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI :
(Sami Baholli)
Sami Baholli


KRYETARI :
(Haxhi Lleshi)
Haxhi Lleshi

U shtyp në 5 kopje

AQSH E 489 v 1961 D 25 U 50

Nëntë vjet më vonë, më 15 tetor 1970, Shahin Toçi shpallet dëshmor i atdheut. Mati dhe gjithw Shqipwria krenohej me të drejtë me qëndrimin burrëror e patriotik të djalit të tij, heroit Shahin Toçi.

Më 10 shkurt 1994, Shahin Toçi dekorohet nga Presidenti i Republikës me “Urdhërin e Flamurit Kombëtar Kl I-rë” me motivacioni : “ ATDHETAR I SHQUAR, SAKRIFIKOJ JETËN NË LUFTË PËR LARTËSIMIN E KOMBIT”.



Ndërsa më 25 mars 2011 dekorohet nga Presidenti i Republikës me “Medalajen e Artë të Shqiponjës”, me motivacionin: **NË NDERIM TË THELLË TË AKTIT TË LARTË QYTETAR DHE PATROTIK PËR KUNDËRSHTIMIN PËR TU BETUAR SI USHTARAK, PARA FLAMURIT FASHIST ITALIAN, NË MAJ TË VITIT 1939, ÇKA DO TI KUSHTONTE JETËN MË PAS, POR QË DO TË MBETEJ NDËR SHEMBUJT GJITHNJË FRYMËZUES TË DINJITETIT DHE ATDHEDASHURISË”.**, dekoratë e dhënë gjatë ceremonisë së kthimit të eshtrave të patriotit në atdhe pas 72-vitesh, dorëzuar familjes së Shahin Toçit.





Tirane 25/03/2011

Të dashur miq, motra dhe vëllezër të Familjes
Z. Shahin Toçi

Ju përshëndesim për nismën tuaj për sjelljen në Atdhe të eshtrave të patriotit Z. Shahin Toçi. Edhe pse në moshë të re, Ai tregoi se Atdheu e kombi është mbi çdo gjë edhe mbi jetën e tij.

Eshtrat e Tij do të pushojnë më së fundmi në tokën e vendit që aq shumë e deshi, të cilit i fali edhe jetën e tij.

Vëllazërisht,

LEKA I ZOGU
MBRET I SHQIPTARËVE